



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KRYETARI

VENDIM

Nr. 8695 / datë 21.02 2019

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI KRYERJEN E PRAKTIKËS NË BASHKINË TIRANË”


Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1,1. shkronja “b”, nenit 64, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë; vendimit nr. 6748, datë 17.02.2017 të Kryetarit Bashkisë “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë së Tiranës”, si dhe në vijim të memos së Drejtorisë së Përgjithshme e Planifikimit strategjik dhe Burimeve Njerëzore me nr.prot. 8695, datë 21.02.2019.

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Mbi kryerjen e praktikës në Bashkinë Tiranë”, sipas materialit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Vendimi nr. 31586, datë 31.08.2017 i Kryetarit Bashkisë “Për miratimin e rregullores “Mbi kryerjen e praktikës mësimore të studentëve me arsim të lartë pranë Bashkisë Tiranë”, shfuqizohet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



Erion Veliaj